



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

---

Numri i lëndës: 2021:270847  
Datë: 20.03.2024  
Numri i dokumentit: 05476015

**C.nr.2602/2021**

GJYKATA THEMELORE PRIZREN – **Departamenti i përgjithshëm – Divizioni civil**, gjyqtari Taulant Rexhëbeqaj, me bashkëpunëtoren profesionale H.D. në çështjen juridiko-kontestimore të paditësit M.T. nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson E.G.G. avokate nga Prizreni, kundër te paditurit L.B. nga Prizreni, për shkak të kompensimit të dëmit jomaterial, vlera e kontestit 3,500.00 euro, gjatë përgatitjes së seancës për shqyrtim përgatitor-kryesor, jashtë seance, me datë 20.03.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**  
**-Për përgjigje në padi-**

**I. DETYROHET** i padituri L.B. nga Prizreni, që në afat prej 15 ditësh nga dorëzimi i padisë me të gjitha shkresat, të cilat i janë bashkangjitur këtij aktvendimi, t'i paraqesë gjykatës përgjigje në padi në formë të shkruar, në 2 (dy) ekzemplar, nën kërcënim të pasojave procedurale.

**II.** I padituri është i detyruar që në përgjigje në padi t'i paraqesë prapësimet procedurale dhe të deklarojë se e pranon apo e konteston kërkesëpadinë e paditësit. Në qoftë se, i padituri e konteston kërkesëpadinë e paditësit, përgjigja në padi duhet t'i përmbajë faktet mbi të cilat i padituri i bazon thëniet e tij dhe provat me të cilat pranohen faktet e paraqitura. Përgjigja duhet t'i përmbajë të gjitha elementet e parapara me dispozita nga neni 99, i LPK-së.

**III.** Në qoftë se, përgjigja në padi është e pakuptueshme apo e jo e plotë, me qëllim të eliminimit të këtyre të metave, gjykata do të veprojë në pajtim me dispozitat e nenit 102, të LPK-së.

**IV.** Paralajmërohet i padituri se në qoftë se brenda afatit të caktuar në pikën I të këtij aktvendimi nuk e paraqet përgjigjen në padi, atëherë gjykata do të merr aktgjykim për shkak të pa dëgjueshmërisë – mosbindjes, po që se plotësohen kushtet e parapara me dispozitat e nenit 150 par.1, pika (a), (b),(c) e LPK-së.

**V.** Personi i cili paraqitet si përfaqësues ligjor është i detyruar që me rastin e ndërmarrjes së veprimit të parë procedural të provojë cilësinë e përfaqësuesit ligjor, ndërsa i autorizuari me ndërmarrjen e veprimit të parë procedural është i detyruar që gjykatës t'ia paraqes autorizimin në rregull.

**A r s y e t i m**

Numri i lëndës: 2021:270847

Datë: 20.03.2024

Numri i dokumentit: 05476015

Gjyqtari i çështjes, në pajtim me dispozitat e nenit 394, 395, al.1 dhe 2, 396, 397, 99, 102, 77 al.2, 93 al.1, dhe 387 al.1 pika (a) e LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL**  
C.nr.2602/2021, datë 20.03.2024

**G j y q t a r i,**

\_\_\_\_\_  
**Taulant Rexhëbeqaj**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.